

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Gyltene Sylejmani, anëtarë, në çështjen juridike të paditëses F. M., nga komuna e Prishtinës, të cilën me autorizim e përfaqëson E. A., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Limak Kosova”, të cilin e përfaqëson F. Gj., objekti i kontestit anulimi i vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe kompensimi i të ardhurave personale, duke vendosur përkitazi me revizionin e të paditurës, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3649/2015 datë 26.9.2016, në seancën e kolegjit të mbajtur më 10.7.2017, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3649/2015 datë 26.9.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA.nr.3649/2015 datë 26.9.2016, është refuzuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, C.nr. 196/2014 datë 6.5.2015, me të cilën është anuluar njoftimi i të paditurës Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Limak Kosova” sh.a., për mos përtrirjen e kontratës së punës të paditësit të datës 3.4.2014 dhe obligohet e paditura që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi ta kthejë paditësen në detyrat e punës “Check Ibis Agent”. Obligohet njëherit e paditura që paditëses në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit të paguajë shumën prej 8.165,17 €, në emër të fitimit të humbur për shkak të mos realizimit të të ardhurave personale për periudhën prej 3.4.2014 deri më 30.4.2015, me kamatë ligjore prej 8% vjetore duke llogaritur nga dita 30.4.2015 deri te

pagesa definitive me kërcënim të përmbarimit të dhunshëm. Obligohet e paditura që paditëses t'i paguajë shpenzimet procedurale në shumën prej 574,40 € në afat prej 15 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi me kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë e paditura në afat ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet si i bazuar revizioni i të paditurës dhe aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë të ndryshohen dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit ose të njëjtat të prishen dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur në kuptim të nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni i të paditurës është i pabazuar.

Në procedurë të zhvilluar pranë gjykatës së shkallës së parë është vërtetuar fakti se paditësja që nga viti 2003 ka qenë në marrëdhënie pune në ish Aeroportin e Prishtinës. Me marrjen e Aeroportit të Prishtinës nga e paditura me koncension, paditësja ka lidhur kontratë pune me të paditurën në kohëzgjatje prej 04.4.2011 deri më 03.4.2014, me mundësi të vazhdimit edhe për një vit. Me njoftimin e të paditurës më 20.3.2014, paditësja është paralajmëruar se do t'i shkëputet kontrata e punës dhe nuk do t'i ofrohet kontrata e re. Gjatë inspektimit Inspektorati i Punës të Kosovës me vendimin e saj VN.nr. ... datë ..., ka urdhëruar të paditurën që të zbatojë dispozitat e nenit 49, 53 dhe 71 të Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës nr. 03/L-212. E paditura në përgjigjen e padisë ka theksuar se me paditësen ka ndërpre kontratën e punës në bazë të Ligjit të Punës në fuqi.

Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike ka konstatuar se paditëses i është ndërprerë kontrata e punës në kundërshtim me nenin 10 pika 3 të Ligjit të Punës (nr. 03/L-212), pasi që paditësja të e paditura është në marrëdhënie pune me gjatë se 10 vite, andaj sipas dispozitës në fjalë konsiderohet si kontratë për një periudhë të pa caktuar kohore. Gjykata e shkallës së parë në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike vlerëson se e

paditura është e obliguar që paditësen ta kthejë në detyrat e punës që ka pasur sipas kontratës së punës me të ardhurat të porealizuara për periudhat nga largimi nga puna e gjer më 30.4.2015.

Në procedurë të vendosjes sipas ankesës së paditurës gjykata e shkallës së parë të njëjtin e ka refuzuar si të pabazuar, duke vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe duke pranuar të gjitha konstatimet faktike dhe juridike të gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë njëherit vlerëson se marrëdhënia e punës së paditëses është e karakterit të përhershëm, pasi që paditësja këto punë i ka kryer më tepër se 10 vite. Njëherit vlerësohet nga gjykata e shkallës së dytë se e paditura nuk ka zhvilluar procedurat të caktuara për tepricë teknologjike, as që ka nxjerr program të përshtatshëm për këta punëtorë.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke pranuar në tërësi thëniet e qëndrimit juridik të arsyetimit të aktgjyimit të gjykatës së shkallës së dytë është e mendimit se drejt e ka zbatuar të drejtën materiale gjykata e shkallës së dytë kur ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Thëniet e revizionit se aktgjykimi i goditur përmban shkelje thelbësore nga neni 182.2 pika (n) të LPK, të cilat sipas revizionit kanë të bëjnë me atë se aktgjykimi i atakuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e dhëna janë kundërthënëse me arsyetimin në përgjithësi. Gjykata e revizionit konstaton se këto thëniet e revizionit janë të pabazuara, nga fakti se në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe atë të shkallës së dytë janë dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare juridikisht të vlefshme për gjykim të drejtë në këtë çështje juridike të cilat janë të pranueshme edhe nga kjo Gjykatë. Gjykata e shkallës së dytë me rastin e vendosjes sipas ankesës së të paditurës, ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore, për të njëjtat ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse të cilat janë të pranuar edhe nga gjykata e revizionit.

Gjykata vlerësoi edhe thëniet e revizionit se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë nuk kanë marrë për bazë faktin ligjore dhe atë të nenit 9.18 të Marrëveshjes së Partneritetit Publiko Privat e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Kompanisë Private

“Limak” të datës 12.8.2010, në bazë të kësaj marrëveshje Kompania “Limak” merr obligim që punëtorët t’i mban në punë për 3 vite, ku pas kësaj periudhe nuk mbart asnjë përkufizim pas përvjetorit të tretë të datës së hyrjes në fuqi të kontratës së punës, gjykata vlerëson si të pabazuara pasi që e paditura ka vazhduar subjektiviteti e ish Aeroportit të Prishtinës duke marrë përgjegjësinë ndaj punëtorëve të Aeroportit dhe se nuk ka asnjë arsye ligjore dhe se e paditura ka mundur ta ndërprejë marrëdhënien e punës vetëm në kushtet e parapara me nenin 70 të Ligjit të Punës e kurrësi në bazë të nenit 67.1 dhe 3 të këtij Ligji, ku thuhet se kontrata e punës sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së punës. Në rastin konkret me njoftim, ashtu siç ka vepruar e paditura, nuk ka pas mundësi që paditëses të mos i vazhdohet kontrata e punës ku kontrata e saj e punës konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar.

Gjykata e shkallës së parë lidhur me lartësinë e të ardhurave personale ka caktuar duke marrë për bazë raportin e ekspertit dhe me këtë rast gjeti se fitimi i humbur për periudhën prej 03.3.2014 deri më 30.4.2015 është në shumën prej 8.165,17 €, të cilat e paditura është e obliguar të paguajë në kuptim të nenit 173 dhe 174 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, prandaj edhe pretendimet e revizionit se me këtë rast është bërë zbatim i gabuar i së drejtës materiale nuk qëndron.

Për arsyet e sipërpërmendura u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nënti 222 të LPK.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.70/2017, më 10.7.2017

Kryetari i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri